



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.56/2019
Prishtinë, më 25.01.2019, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Glauk Konjufca, Liburn Aliu, Hykmete Bajrami, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë dhe Duda Balje, anëtare.

Pjesëmarrjes i ftuar: Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik

Pjesëmarrës: Lulzim Demolli dhe Shkumbin Asllan –MZHE Ardian Syla – Bordi i Trepçës; Shyqyri Sadiku – Sindikata e Trepçës; Nazmi Mikullofci, Blerim Sallahu dhe Vatra Qehaja - LVV; Naim Jakaj- PSD; Liridon Gashi – SEEF dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Nuriye Morina

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22.1.2019;**
- 3. Shqyrtimi Projekt-Statutit të Trepça SH.A.;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22.1.2019;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 22 1.2019, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi Projekt-Statutit të Trepça SH.A.;

Sala Berisha Shala, kryetare, tha se edhe në mbledhjen e kaluar të Komisionit, në rendin e ditës ishte shqyrtimi i Projekt-statutit Trepça SH.A., por ky projekt – statut u kthye prapa nga Komisioni me qëllim që të harmonizohet marrëveshja në mes Qeverisë, Bordit Mbikëqyrës të Trepçës dhe Sindikatës së punëtorëve të Trepçës. Jemi pajtuar në Komision që mos të ketë ndërhyrje dhe ndryshime në Projekt – Statut, pas marrëveshjes në mes këtyre palëve dhe si i tillë duhet të procedohet për miratim në Kuvend, në mënyrë që pastaj të mos ketë problem në zbatim, pasi që palët nënshkruese duhet ta zbatojnë, sepse në mbledhjen e kaluar nuk u pajtuat të miratohet për shkaqe procedurale dhe kërkuam që ai ti kthehet Qeverisë. Për këtë çështje është i ftuar z. Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, të cilit ia kaloi fjalën, për ta paraqitur Projekt –Statutin të Trepça SH.A.

Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, i njoftoi anëtarët e Komisionit në lidhje me procesin se si ka rrjedhur puna e hartimit të Projekt-statutit Trepça SH.A.. Në muajin maj të vitit 2018, është hartuar Projekt – statuti i Trepçës, por ai solli pakënaqësi te minatorët e Trepçës. Për zgjidhjen e pakënaqësive dhe për të arritur një marrëveshje të përbashkët, janë krijuar dy grupe punuese; më 31 tetor 2018, këto grupe punuese kanë paraqitur raportet e tyre. Rportet janë trajtuar po atë ditë dhe të gjithë së bashku kanë arritur një marrëveshje. z. Lluka e paraqiti Projekt-statutin, i cili tha përcakton themeluesit e shoqërisë aksionare, aksionet e tyre, veprimtarinë, strukturën organizative, kapitalin themeltar, menaxhimin, afarizmin dhe të gjitha çështjet organizative që lidhen me kompaninë. Emërtimi i shoqërisë aksionare është “Trepça” Sh.A dhe selia e saj është në Parkun Industrial të Mitrovicës, prandaj miratimi Statutit të Shoqërisë Aksionare “Trepça” Sh.A., do të mundësojë zbatimin e Ligjit për Trepçën dhe versionin i miratuar është në pajtueshmëri të plotë nga të gjithë aktorët që kanë lidhje nga kjo kompani. Tash, ky Projekt-statut është drafti final, i arritjes së marrëveshjes në mes të palëve, Bordit të Trepçës dhe Sindikatës së punëtorëve të Trepçës SH.A. Lluka tha, se po në të njëjtën ditë kur është kthyer prapa Projekt - statuti, nga ana e Komisionit Parlamentar, jemi mbledhur të gjithë së bashku dhe janë trajtuar të gjitha çështjet e hapura veç e veç dhe ky është versionin final, pasi që janë pajtuar të dy palët, është nënshkruar një marrëveshje e përbashkët, të cilën edhe ju e keni si Komision, ndërsa, sot sipas procedurës, në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, është miratuar ky Projekt-statut.

Hykmete Bajrami, kërkoi sqarime në lidhje me fabrikën e pajisjeve në statutin e Trepçës. Në nenin 7, tek paragrafi 2, i referohet studimit të fizibilitetit të Ligjit për Trepçën, pse nuk ka pasur studim të veçantë për këtë çështje në statut? Çka do të ndodhë me listën e aseteve që janë

jashtë Kosovës, që i ka Trepça? A ka mbetur ndonjë hektarë tokë në Mitrovicë, që është në pronësi të ndërmarrjes Trepça pa u regjistruhu si aset i Trepçës? Çka do të bëni me listën e aseteve që Agjencia Kosovare e Privatizimit i ka regjistruar dhe ka bërë një inventarë? Bajarami tha, se nëse një Projekt -statut i tillë përjashton asetet e Trepçës, po shpresoj që përjashtimi i këtyre pajisjeve të mbetet nën përgjegjësinë e Bordit Mbikëqyrës, për ti rikthyer në ndërmarrjen Trepça.

Liburn Aliu, tha se në këtë Projekt -statut ka disa probleme serioze ekonomike dhe juridike dhe me këtë nguti do t'na përvidhen gabime, siç ka ndodhur edhe më Ligjin për Trepçën. Ai theksoi se ku bëhet fjalë për aksionet, ku thuhet që e kanë vlerë 1 euro, kjo nuk mund të përcaktohet sepse jo të gjitha aksionet e kanë vlerën 1 euro. Nëse kështu e votojmë, na del një statut me probleme ekonomike e juridike. Ka edhe probleme të tjera, prandaj do t'ju lusja që mos të bëhen gabimet, që kanë kaluar sikurse në Ligjin për Trepçën.

Lutfi Zharku, kërkoi sqarim lidhur më përfshirjen e emrave të anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Trepçës në Projekt –statut? Ai tha se kjo nuk është praktikë e mirë dhe nuk është e parapare me ligj.

Glauk Konjufca, i paraqiti vërejtjet në Projekt-statut, tek neni 14.1. Bordi Mbikëqyrës i Trepçës përcakton dividendin, kjo dividendë nuk duhet t'i lihet Bordit Mbikëqyrës më vendim, por të përcaktohet vetëm sipas Ligjit për Trepçën, sepse nuk len mundësi të keqpërdorimit të dividendit, Ai tha se nëse Projekt-statuti votohet me gabime shumë elementare, më vonë nuk e di a ka hapësirë që këto të përmirësohen. Andaj, çdo pajtueshmëri mes palëve në këtë rast, nuk eliminon problemet që ekzistojnë dhe nëse votohet kështu, do të ketë organizata joqeveritare, që i marrin dhe i analizojnë, do të kemi probleme në zbatim, por ndonjë palë mund të dërgojë edhe në gjykatë. Konjufca potencoi se Projekt-statuti ka probleme elementare, prandaj problemet vijnë në formë të materies të cilat i ka ky statut. Ai theksoi se definimi i aseteve jashtë territorit të Republikës së Kosovës, është i domosdoshëm dhe pyeti pse nuk është ngritur kjo çështje në Projekt-statut dhe pse në statut nuk ka strategji dhe vizion, se çka dëshirojmë të arrijmë?

Memli Krasniqi, tha se ky nuk është Projekt - statuti ideal, por është më optimali, mirëpo, si i tillë duhet të kalojë në mënyrë që t'i hapet rrugë zhvillimit të Trepçës. Nuk mendoj që po ngutemi, por jemi vonuar, tash një kohë të gjatë, prej kur e kemi pasur në shqyrtim këtë projekt-statut dhe nuk e kemi miratuar. Lidhur më hezitimet se mos po gabojmë dhe po ngutemi për miratim, Krasniqi theksoi se statuti i ka lënë mundësitë e ndryshimeve. Në nenin 17 është lënë kjo mundësi, për rastet kur ka problem në zbatim, prandaj, ky Projekt - statut e hap mundësinë e ecjes përpara. Me gjithë defektet që mund të jenë, ky statut është më i miri i mundshmi.

Muharrem Nitaj, theksoi se ashtu siç u tha, që ky Projekt-statut, nuk përmbillet nëse miratohet kështu në formën siç është, por mbet i hapur gjatë procesit për ndryshim, nëse është e nevojshme të plotësohet, për t'u zbatuar në praktikë. Prandaj, me gjithë mangësitë, ky statut duhet të miratohet, sepse është një bazë e fortë, që të hapet perspektiva kësaj ndërmarrje me rendësi të veçantë, që është në të mirën e zhvillimit ekonomik të vendit.

Liburn Aliu, potencoi se për dallim nga Projekt -statuti i kaluar, ky është më i kompletuar dhe ka një përparim mjaft të madh sepse janë përfshi edhe asetet e Trepçës. Ai theksoi së është e

rëndësishme që të ketë marrëveshje mes Sindikatës së Punëtorëve dhe Bordit Mbikëqyrës të Trepçës dhe të futen asetet e Trepçës. Aliu theksoi për atë që ka qenë skeptik në mbledhjen e kaluar, nëse përmes komisionit ka qenë një procedurë, që mund të ketë pasur amendamente, ka pasur mundësi për ta ndryshuar komplet përmbajtjen e statutit, prandaj, ne e kemi një ligj që ka shumë probleme serioze. Frikësohem se në statut, prapë do të përvidhen gabime, sikurse në ligj. Kjo po bëhet pak me nguti sepse nëse e lexojmë, e shohim që ka gabime dhe nuk jemi kundër, mirëpo, këto janë problemet.

Kryetarja, potencoi se kërkesë e anëtarëve të Komisionit ka qenë të votohet Projekt – statutim, pasi që është arritur marrëveshja me përfshirjen e kërkesave të Sindikatës së Punëtorëve të Trepçës. Marrëveshja si e tillë ka qenë jo shumë e arsyeshme për zhvillimin ekonomik të Trepçës, por ne i hapim rrugë Trepçës të funksionojë si njësi e vetme nëse e votojmë, sepse edhe unë nuk jam e kënaqur. Po e quani ngutje nëse votojmë miratimin Projekt - statutit të Trepçës, a në fakt që tri vite është miratuar Ligji për Trepçën, i cili e ka paraparë hartimin e statutit dhe miratimin e tij në Kuvend, pyes tani, a është nguti apo zvarritje?

Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, duke iu përgjigjur shqetësimeve të anëtarëve të Komisionit për problemet në Projekt –statut, tha se Statuti është dokument që mund të ndryshohet. Ai tha se vizioni për zhvillim nuk është pjesë e statutit, por krijohet një plan biznesi sepse me ndryshimin e menxhmentit ndryshon edhe vizioni. Për Fabrikën e pajimeve kam deklaruar që fillimisht ka qenë jashtë, por ajo tash është e përfshirë. Për asetet jashtë vendit, tha që janë të përfshira në Projekt-statut. Çështja e ndarjes së aksioneve, tha se do të rregullohet më një udhëzim administrativ. Në lidhje me përfshirjen e emrave të anëtarëve të Bordit të Trepçës në Projekt –Statut, Lluka tha që nuk ka qenë vendimi i tij, por i Bordit, ndërsa lidhur më vlerësimin e asetëve të ndërmarrjes Trepça, tha se do të bëhet një vlerësim i asetëve nga një kompani e jashtme e pavarur. Lluka, tha që edhe për benefitet sociale jemi pajtuar që të trajtohen veçmas, sepse nuk e kanë vendin në statut. Prandaj, ky Projekt-statut është version i kompletuar. Si i tillë ka kaluar në Qeveri dhe kërkoi që ai të votohet edhe në Komision.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Projekt-statuti i Trepça SH.A.

**4. Të ndryshme.
Çështjet vijuese.**

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Sala BERISHA SHALA